

VENDIM
Nr.811, datë 16.12.2005

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PËR FINANCIMIN E SHËRBIMIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR, NË QARKUN E BERATIT, NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR SI BURIM I VETËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 36 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 24 e 26 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor (KSHP), në qarkun e Beratit, nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, si burim i vetëm.
 2. Ky financim të fillojë nga data 1 janar 2006.
 3. Për përgatitjen e udhëzimeve për përcaktimin e statusit, të misionit, funksioneve të paketës bazë të shërbimeve, që duhet të ofrojnë këto institucione, si dhe të nivelit të autonomisë së tyre, financiare e menaxheriale, ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
 4. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, mbështetur në paketën e shërbimeve, që do të ofrojnë institucionet publike të kujdesit shëndetësor parësor, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, të hartojë, negociojë dhe të lidhë kontrata shërbimi me institucionet publike të kujdesit shëndetësor parësor të qarkut të Beratit.
 5. Kontrata e shërbimit të parashikojë mbulimin e shpenzimeve të institucionit publik vetëm për ofrimin e shërbimeve (pa përfshirë financimin e investimeve kapitale), një pagesë fikse për shpenzimet për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni, si dhe një pagesë, në bazë të nivelit të institucionit në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor.
 6. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë, që, pas miratimit të buxhetit të saj për vitin 2006, t’i kalojë Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor fondet buxhetore, të parashikuara për shpenzimet korente për vitin 2006 (shpenzime personeli dhe shpenzime operative) për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor të qarkut të Beratit.
 7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha